KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**NEWSLETTER** | SEPTEMBER 8th, 2023

# UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**September 13-14** | **Regional Business Forum "The Western Balkans in 2030 and beyond"**
**September 20–21** | **DMEXCO Köln**
**September 26** | **East-West BAYERN Forum**
**September 26** | **Business Forum "Phasing in into the single market as the potential for growth for the Western Balkans" Tirana**
**October 7-11** | **ANUGA Köln**
**October 11-12** | **9th BME Purchasing Initiative Western Balkans**
**October 25-26** | **Supplier Balkan Expo-SUBEX Skopje**

## DIRECTOR'S NOTE

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Javën që po lëjmë pas ekipi ynë ka vazhduar me vizitat e anëtarëve në terren, deri më tani kemi vizituar 52 kompani anëtare. Që nga fillimi i vitit OEGJK-s iu kanë bashkangjitur 44 anëtarë të rinj, deri në fund të këtij viti OEGJK do të jetë oda më e madhe bilaterale në vend.

Jemi shumë krenar që investitori më i madh gjerman në sektorin e prodhimit në Kosovë, MUNDA është anëtarësuar në OEGJK.

MUNDA Textile Lichtsysteme GmbH, është një ndërmarrje e përbashkët e AUNDE, furnizues lider në nivel ndërkombëtar i sektorit të automobilave dhe ndërmarrja MENTOR, një nga specialistët kryesorë në Gjermani për ndiçimet e integruar. MUNDA do të filloj prodhimin në fillim të vitit 2024, në Komunë të Obiliqit. Ekipi ynë përgjatë dy viteve të fundit ka asistuar dhe mbështetur që ky investitor gjerman të marrë vendim për të investuar në Kosovë.

Gjatë javës që kemi lënë pas, kanë vazhduar dhe aktivitetet tona avokuese. OEGJK është në dialog të vazhdueshëm me Qeverinë e Kosovës.

Deri në fund të shtatorit, përmes grupeve punuese në Kllasterë ekipi është duke mbledhur input për planin vjetor 2024. Jemi mirënjohës për kontributin tuaj të vlefshëm në grupet tona punuese!

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

During this week, our team continued member visits, so far we have visited 52 member companies. Since the beginning of the year, 44 new members have joined KDWV, until the end of this year KDWV will be the largest bilateral chamber in the country.

We are very proud that the largest German investor in the production sector in Kosovo, MUNDA, has joined KDWV.

MUNDA Textile Lichtsysteme GmbH is a joint venture of AUNDE, a leading international supplier to the automotive sector, and MENTOR, one of the leading specialists in Germany for integrated lighting systems. MUNDA will start production at the beginning of 2024, in the Municipality of Obiliq. During the last two years, our team has assisted and supported this German investor to decide to invest in Kosovo.

During the past week, our advocacy activities continued. KDWV is in a constant dialogue with the KOS-Government.

By the end of September, our team is collecting input - through working groups in the Clusters- for our annual activity plan 2024. We are grateful for your valuable contribution in these working groups.

## Publikohet raporti ekonomik për Kosovën

German Economic Team me kërkesë të Ministrisë Federale për Ekonomi dhe Mbrojtje të Klimës këshillon Qeverinë e Republikës së Kosovës, me fokus në politika makroekonomike. Në baza të rregullta mbahen takime me Qeverinë gjermane për t'i informuar rreth punës së GET në Kosovë.

Gjatë javës që lam pas u prezantua raporti i radhës për Kosovën nga German Economic Team, në takim përpos përfaqësuesve të qeverisë gjermane ishte dhe OEGJK.

Raportin mund ta shkarkoni këtu.

## The latest economic report for Kosovo has been published

At the request of the Federal Ministry for Economy and Climate Action, the German Economic Team advises the Government of the Republic of Kosovo, with a focus on macroeconomic policies. On a regular basis, GET informs the German Government on the progress of their work in Kosovo.

During this week, the latest Kosovo report was presented by the German Economic Team, in addition to the representatives of the German government, KDWV also participated at this meeting.

You can download the report here.

---

## Kërkesa e OEGJK-së realizohet nga Qeveria e Kosovës, për vendosjen e paneleve solare

Qytetarët e Republikës së Kosovës nuk do të kenë nevojë që të pajisen me leje ndërtimore për vendosjen e paneleve solare fotovoltaike për konsum familjar, me kapacitet deri në 7 kW.

Ky ndryshim do të jetë një lehtësim për qyetarët që duan të instalojnë kapacitete të tilla, që do të pasohet me rritje të prodhimit nga kompanitë prodhuese vendore të paneleve solare.

Kjo kërkesë ka ardhë nga Klasteri i Energjisë së Ripërtëritshme të OEGJK-së dhe Rrjeti i Bizneseve për Energji të Pastër (N4CEB), që është e themeluar nga OEGJK me përkrahje të Qeverisë Gjermane përmes GIZ dhe synon t'i japë sektorit privat një zë të fortë, duke nxitur debatin publik dhe gjithashtu të theksojë rekomandimet drejtuar autoriteteve.

## The request of KDWV is fulfilled by the Government of Kosovo, for the installation of solar panels

Citizens of the Republic of Kosovo will not need to obtain a construction permit for the installation of solar photovoltaic panels for family consumption, with a capacity of up to 7 kW.

This change will be a relief for citizens who want to install such capacities, which will be followed by increased production by local solar panel manufacturing companies.

This request was initiated by the Cluster for Renewable Energy of KDWV and the Network for Clean Energy Businesses (N4CEB), which is established by the KDWV with the support of the German Government through GIZ, to give the private sector a strong voice, promoting public-private dialogue and give recommendations to policymakers.

## Drejtoresha e OEGJK priti një delegacion gjerman për t'i informuar rreth Kosovës

Fondacioni politik gjerman Konrad Adenauer Stiftung (KAS) ishte nikoqir i një delegacion gjerman të përbërë nga CEO gjermanë, organizata dhe shoqata biznesi.

Drejtoresha e OEGJK-së, Nora Hasani ishte ftuar për t'u takuar me pjesëmarrësit e delegacionit dhe për t'ua dhënë një pasqyrë të zhvillimeve më të fundit ekonomike në Kosovë. Ajo informoi të pranishmit për marrëdhëniet ekonomike gjermano-kosovare, investimet e fundit dhe aktivitetet aktuale të OEGJK si dhe rolin çdo herë e më të madh që ka kjo Odë në rritjen dhe nxitjen e marrëdhëniet dypalëshe, ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë.

Gjermania mbetet investitori më i madh i huaj në Kosovë dhe është një nga partnerët më të rëndësishëm tregtarë. IHD-të gjermane në Kosovë nga janari deri në qershor arritën në 92 milionë euro.

Nga ana tjetër, eksporti i produkteve kosovare në Gjermani në 7 muajt e parë të këtij viti ka arritur në 52 milionë euro, ndërsa importi i produkteve gjermane në të njëjtën periudhë ka arritur në 414 milionë euro.

## U mbajt mbledhja e 32-të e Asamblesë së ITP Prizren

Gjatë javës që kemi lënë pas është mbajtur mbledhja e 32-të e Asamblesë së Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve (Innovation and Training Park - ITP) Prizren. Në këtë mbledhje Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ka marrë pjesë si anëtare bashkë me përfaqësuesit e Qeverisë Gjermane dhe përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës. Roli i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare në këtë mbledhje është rol vëzhgues dhe përfaqëson sektorin privat.

## A German delegation was informed about the economy of Kosovo by the director of KDWV

The German political foundation Konrad Adenauer Stiftung (KAS) hosted a German delegation comprised of German CEOs, organizations and business associations.

The director of KDWV, Nora Hasani was invited to give an overview of the latest economic developments in Kosovo, and inform the participants about the German-Kosovar economic relations, latest investments and the current activities of the association as well as its growing role in fostering bilateral relations.

Germany remains the largest foreign investor in Kosovo and is one of the most important trade partners. German FDI to Kosovo from January to June reached 92 million euros.

On the other hand, the export of Kosovar products to Germany in the first 7 months of this year reached 52 million euros, whereas the import of German products reached 414 million euros, in the same period.

## The 32nd meeting of the Assembly of ITP Prizren was held

The 32nd meeting of the Assembly of the Innovation and Training Park (ITP) Prizren was held. In this meeting, the German-Kosovar Business Association participated as a member together with the German Government and representatives of the Government of Kosovo. KDWV is an observer at this Assembly and represents the private sector. During this meeting new requests of foreign and local companies for placement in the ITP were reviewed.

Përgjatë kësaj mbledhje janë shqyrtuar kërkesat e reja të kompanive të huaja dhe vendore për vendosje në ITP.

ITP Prizren është projekti më i madh bilateral, që bashkë-financohet nga Qeveria Gjermane dhe Qeveria e Kosovës, teksa menaxhohet përmes GIZ-it.

Për më shumë: https://itp-prizren.com/

ITP Prizren is the largest bilateral project, co-financed by the German Government and the Government of Kosovo, as it is being managed through the German International Cooperation, GIZ.

More information on the ITP: https://itp-prizren.com/

**Edicioni i 4t. i GreenTalk**

Fjalimin e parë mbi "Planet e qeverisë për implementimin e masave të efiçiencës" e mbajti Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, e cila theksoi se që nga skema e kaluar, qeveria ka pasur interesim rekord në termoizolim, si rezultat është ngritur edhe vetëdijësimi i qytetarëve për efiçiencën. Vetëm këtë vit 39.5 milionë euro do të investohen në sektorin rezidencial dhe publik për rritje të energjisë efiçiente.

OEGJK u përfaqësua në këtë takim nga Sytrime Dervisholli, e cila adresoi te Ministrja Rizvanolli çështjen e lejimit të ndërtimit të sistemeve solare në lokacionet të cilat nuk janë të përfshira në Planin Zhvillimor të Komunave.

Ministrja Rizvanolli tha që është duke punuar në këtë drejtim së bashku me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

**4th edition of GreenTalk**

The opening speech on "Government's Plans for Implementing Efficiency Measures" was delivered by the Minister of Economy, Artane Rizvanolli, who emphasized that since the previous program, the government has shown a record interest in thermoinsulation, resulting in increased awareness among citizens regarding efficiency.

This year, 39.5 million euros will be invested in the residential and public sectors to promote energy efficiency.

The German-Kosovar Business Association (KDWV) was represented at this meeting by Sytrime Dervisholli, who raised the issue with Minister Rizvanolli concerning the approval of solar system installations in locations not included in the Municipal Development Plan.

Minister Rizvanolli mentioned that she is working on this matter in collaboration with the Ministry of Environment, Spatial Planning, and Infrastructure.

**Business After Hours bën bashkë anëtarët për bashkëpunime të reja**

Anëtarët tanë u mblodhën për një mbrëmje rrjetëzimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi të njohurive. Ishte një mundësi fantastike për kompanitë anëtare të OEGJK që të njihen mes

**Business After Hours brings members together for new collaborations**

To create more opportunities for members, to meet, exchange and explore possible business opportunities KDWV organizes once a month a meet-up, after regular business hours.

vete dhe potencialisht të krijojnë bashkëpunime të reja.

Energjia dhe entuziazmi i shfaqur nga të gjithë me të vërtetë e bën "Business After Hours" një ngjarje të suksesshme për komunitetin tonë, meqë e ka natyrën jo-formale dhe ofron kanale shtesë të komunikimit me Odën dhe mes vet bizneseve anëtare.

Ju mirëpresim në event e radhës!

This time, during the Business After Hours especially our new members gathered for networking. Each time, we really enjoy the great atmosphere and appreciate the interesting topics that are raised.

Come by next month! We'd be happy to welcome you!

## Vizitat në biznese

Përgjatë kësaj jave, ekipi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare ka vizituar kompanitë anëtare duke qenë afër kërkesave dhe dhënies së shërbimeve për ta.

Më poshtë mund të gjeni disa fotografi nga këto vizita dhe ngjarjet e OEGJK-së gjatë kësaj jave.

## Visits to member companies

Throughout this week, the team of the German-Kosovar Business Association has visited member companies, being close to their needs and service provision for them.

Below you can find some photos from these visits and other KDWV events.

# OUR WEEK IN PICTURES











KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**NEWSLETTER** | SEPTEMBER 8th, 2023

## YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV



Greta Kazia
Për çështje financiare (pagesa e anëtarësimit/faturat etj.)
greta.kazia@oegjk.org

For financial matters (membership fees/invoices, etc.)

greta.kazia@oegjk.org



Gonxhe Abazi
Për këshillim ligjor të investitorëve gjerman dhe anëtarëve të OEGJK
gonxhe.abazi@oegjk.org

For legal advice to German Investors and members of KDWV:
gonxhe.abazi@oegjk.org



Sytrime Dervisholli
Udhëheqëse e departamentit për avokim dhe marrëdhënie me qeverinë mund ta kontaktoni në:
sytrime.dervisholli@oegjk.org

Head of Department for Advocacy and Government Relations can be contacted at:
sytrime.dervisholli@oegjk.org



Besarta Hyseni
Udhëheqëse e departamentit për mbështetjen dhe shërbimet e anëtarëve është znj. Besarta Hyseni:
besarta.hyseni@oegjk.org

Head of Market Entry and Events can be contacted at:
besarta.hyseni@oegjk.org

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:**
ICON Tower, 9th Floor, Rr. Bekim Fehmiu 110; 10000 Prishtina
Monday – Friday | 8.30 – 16.30